



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 25 datë 4.4.2023

**“PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT NË BUXHETIT E BASHKISË
SË SHKODRËS”**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë 4.4.2023 në mbështetje të nenit 35, pika 1, germa “d”, neni 54 germa ‘dh’ të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të nenit 20, pika 1 dhe 5, të ligjit 68/2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, të pikës 190 të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimi plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”; Ligjin 158/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integritit Evropian, dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri 2014 - 2020, alokimet për vitin 2019; Ligjin nr. 38/2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mali i Zi, Shqipëri, alokimet e vitit 2018; Ligjin nr. 21/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mali i Zi, Shqipëri, alokimet e vitit 2017; Marrëveshjen midis Fondacionit për Autonomi dhe Qeverisje Lokale

(FLAG), në cilësinë e udhëheqësit të projektit dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Malit të Zi, në cilësinë e autoritetit menaxhues. VKB nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025”, sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër me burim financimi donacion në llogari jashtë llogarive të thesarit me afat 30 muaj nga data e fillimit të projektit, 1 mars 2023, në programin 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave, zëri Q1O3A3 në shumën 199,323.96 Euro, konvertuar në lek sipas kursit të këmbimit të ditës që do të transferohet fondi, me burim financimi programin e bashkëpunimit ndërkuftar Mali i Zi – Shqipëri.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela **KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis **Lesha**

Miratuar me 28 vota
Vota Pro 28
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 11.4.2023